

Aplikim - Këshilli Vendor i Rinisë Vorë

Nëse je një i ri i zonës së Vorës, 15 – 30 vjeç dhe dëshiron të jesh zëri i të rinjve të Vorës apliko për t'u bërë pjesë e Këshilli Vendor i Rinisë Vorë .

Këshilli Vendor i Rinisë Vorë është organ këshillimor që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Këshilli vendor i rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:

- a) këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
- b) vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
- c) propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;
- ç) bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.

Çdo i ri, anëtar i Këshillit Vendor të Rinisë do të përfaqësojë të rinjtë e Vorës .Përmes angazhimit në Këshillin Vendor të Rinisë do të zhvillohen aftësitë tuaja prej lideri, njohuritë në fushat sociale dhe politike si dhe do ndërmerrni nisma konkrete për ndryshimin e komunitetit tuaj.

Afati i aplikimit është data 24.03.2025.

Apliko tani për tu bërë pjesë e Këshillin Vendor të Rinisë Vorë. Vetëm të përzgjedhurit do të kontaktohen.

Të gjithë kandidatët e interesuar të dërgojnë CV-në në adresën e Email-it:
arsimi.bashkiavore@gmail.com